REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**MINISTRIA E KULTURES**
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 319 Prot. Tiranë, më 01.03.2018

**VENDIM Nr. 39, datë 21.02.2018**

Në mbështetje të **Ligjit Nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), Neni 47, VKM Nr. 725, datë 21.05.2008** "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë" (i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr.2, datë 21.02.2018, pasi shqyrtoi Raportin e Vëzhgimit Arkeologjik sipërfaqësor, në kuadër ***të projektit "HEC Rehovë" Njësia Administrative Vithkuq, Bashkia Korçë***-subjekti "AVDOLLI" sh.p.k., realizuar nga individ i licencuar në arkeologji Z. Taulant Rama,

**VENDOSI:**

1. Të miratojë Raportin e Vëzhgimit Arkeologjik sipërfaqësor, në kuadër ***të projektit "HEC Rehovë" Njësia Administrative Vithkuq, Bashkia Korçë***-subjekti "AVDOLLI" sh.p.k., realizuar nga individ i licencuar në arkeologji Z. Taulant Rama.

2. Subjekti "AVDOLLI" sh.p.k., duhet të lidhë paraprakisht akt-marrëveshje tre palëshe me subjekt të licencuar në arkeologji, i cili duhet të ndjekë në mënyrë periodike ditore kryerjen e punimeve të gërmimit për projektin "HEC Rehovë" Njësia Administrative Vithkuq, Bashkia Korçë, si dhe Agjencinë e Shërbimit Arkeologjik, e cila do të mbikëqyrë këtë subjekt.

3. Investitori duhet të derdhë detyrimet tatimore për mbikëqyrjen e realizuar nga ASHA, sipas tarifave të miratuara me Urdhërin e Ministrit Nr. 384, datë 21.10 2015 dhe përcaktimeve përkatëse të akt-marrëveshjes tre palëshe.

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

5. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

**KRYETAR**

**MIRELA KUMBARO FURXHI**

**MINISTËR**

**SEKRETAR I KKA**

**RUDINA ZOTO**

Adresa: Rruga "Aleksandër Moisiu", Nr. 76, Tiranë
Tel: ++355 04 45 35 855
email: ***sekretaria.kka@asha.gov.al***
Website: asha.gov.al